

V E N D I M
Nr.88, datë 9.3.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.609, DATË 31.12.1993 “PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMIT TË NAFTËS DHE TË NËNPRODUKTEVE TË SAJ”

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 31.12.1993, bëhen këto ndryshime:

1. Në vazhdim të fjalisë së parë të pikës 2 shtohet fjalia “Çmimi i benzinës RON 70-85 do të merret si çmim maksimal (tavan) përjashtimisht vetëm për periudhën gjer me 31 maj 1994”.

2. Ne pikën 3 bëhen këto ndryshime:

a) Diferencat e çmimit që detyrohen të derdhen në buxhetin e shtetit të gjitha subjektet shtetërore e private për benzinën dhe gazoilin e importuar, ndryshon si vijon:

Lekë për :

	Litër	kg
- Benzinë RON 70-85.....	10	13.5
- Benzinë RON 85.1-95.....	17	23
- Benzinë RON 95.1 e lart...	30	40
- Benzinë pa plumb.....	25	33
- Gazoil.....	1	1.2

b) Në paragrafin e dytë fjalët “benzinën e importuar” të zëvendësohet me “benzinën dhe gazoilin e importuar”, kurse fjalia e fundit e këtij paragrafi shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi me 16 mars 1994

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi